



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 128, datë 19.05.2020

**PËR MIRATIMIN E PJESËMARRJES SË PROKURORËVE NË TRAJNIMET  
E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS PËR  
PERIUDHËN PRILL – QERSHOR 2020**

Në zbatim të neneve 159, pika 2, germa “e”, 186, germat “a”, “b” dhe “c”, 189, pika 1, germa “c”, 272, pikat 1-3, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 5, pikat 1, 2, 3, 5 dhe 6, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në korrespondencën me Shkollën e Magjistraturës dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnimet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për periudhën Prill – Qershor 2020.
2. Të njoftohen për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës dhe magjistratët prokurorë, sipas listave dhe kalendarit të propozuar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KRYETAR**

**GENT IBRAHIMI**

